

Banka Ekonomike Sh.a.

**Pasqyrat financiare dhe raporti i auditorit
Për vitin që përfundon më 31 Dhjetor të vitit 2011
(sipas BQK-së)**

PËRMBAJTJA**FAQE**

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

PASQYRA E POZITËS FINANCIARE

4

PAQYRA E TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE

5

PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITALIN AKSIONAR

6

PASQYRA E RRJEDHËS SË PARASË

7

SHËNIMET NË PASQYRAT FINANCIARE

8 - 34

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

Për aksionarët e Bankës Ekonomike Sh. a.

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Bankës Ekonomike Sh.a ("Banka"), ku përfshihet pasqyra e pozitës financiare deri më 31 Dhjetor 2011, si dhe pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyra e ndryshimeve në kapitalin aksionar dhe pasqyra e rrjedhjes së parasë për atë fund vit, si dhe një përmbledhje të politikave të kontabilitetit dhe shënime të tjera.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit për Pasqyrat Financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përpilimin dhe prezantimin e pasqyrave financiare në përputhje me rregullat e Bankës Qendrore të Kosovës ("BQK") siç është shpjeguar në shënimin 2, dhe për kontrollet e tilla të brendshme siç menaxhmenti përcakton se është e nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare që janë pa gabime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Përgjegjësitë e Auditorit

Përgjegjësia jonë është të shprehim një mendim lidhur me pasqyrat financiare bazuar në auditimin e bërë. Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të jemi në përputhshmëri me kërkesat etike dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin në mënyrë që të përfitojmë një siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare janë pa gabime materiale.

Auditimi përfshin performimin e procedurave për marrjen e dëshmive audituese lidhur me shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare. Procedurat e selektuara për auditim varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë vlerësimin e rrezikut për gabime materiale në pasqyrat financiare, të bëra me apo pa qëllim. Në vlerësimin e këtyre rreziqeve, auditori merr parasysh kontrollet e brendshme relevante në përpilimin dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare, në mënyrë që të dizajnoj procedurat e duhurat të auditimit në rrethana të caktuara, por jo për të shprehur një mendim lidhur me efektivitetin e kontrolleve të brendshme të bankës. Auditimi gjithashtu përfshinë vlerësimin e politikave të duhura të kontabilitetit të përdorura si dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin dhe prezantimin e përgjithshëm të pasqyrave financiare.

Ne besojmë se dëshmitë e auditimit që i kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për të ofruar baza për opinionin tonë.

Baza për Opinion të Kualifikuar

1. Referuar në shënimin 3.) të pasqyrave financiare, Banka ka llogaritur provizionet e përgjithshme (rezervat) për kreditë e klientëve si një përqindje fikse. Siq kërkohet në rregullën nr. IX të Bankës Qendrore të Kosovës, provizionet e tilla të përgjithshme (rezervat) do të llogariten mbi bazën e përvojës së dokumentuar historike, të përshtatura për kushtet aktuale dhe të ardhshme të tregut. Përveç kësaj, metodologjia duhet të rishikohet dhe miratohet nga Banka Qendrore e Kosovës (BQK) gjatë ekzaminimeve në terren. Për shkak të natyrës së të dhënave të Bankës dhe për faktin se metodologjia e përdorur nga Banka në përcaktimin e provizioneve të përgjithshme (rezervave) nuk është miratuar nga BQK-ja gjatë ekzaminimit të fundit në terren që u zhvillua gjatë vitit 2011, ne nuk ishim të kënaqur me mjaftueshmërinë e provizioneve të përgjithshme (rezervave) për kreditë më dhe për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2011.
2. Gjatë auditimit tonë ne kemi vërejtur gabimet në lidhje me llogaritjen e të ardhurave nga tarifat dhe komisionet për mbitërheqje. Për shkak të natyrës së të dhënave të Bankës ne nuk ishim në gjendje të përcaktojmë nëse rregullimet mund të jenë të nevojshme për të ardhurat nga tarifat dhe komisionet e regjistruara në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2011 dhe të ardhurat e shtyra nga tarifat e regjistruara në pasqyrën e pozitës financiare për vitin e mbyllur më pas.

Opinionit i Kualifikuar

1. Sipas opinionit tonë, përveç efekteve të çështjes së diskutuar në paragrafin Bazat për Opinion të Kualifikuar, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare të Bankës më 31 Dhjetor 2011, performancën e saj financiare dhe rrjedhës së pasasë për vitin e mbyllur në këtë datë në përputhje me rregullorën e Bankës Qendrore të Kosovës siç shpjegohet në shënimin 2 të pasqyrave financiare.

Prishtina, Kosova
30 Prill, 2012

Ky raport është përkthim i versionit origjinal në gjuhën angleze, në rast mospërputhjeje midis këtyre dy raporteve, raporti në gjuhën angleze do të mbizotërojë.

Banka Ekonomike Sh.a.
Pasqyra e pozitës financiare
Për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2011

	Note	Më 31 Dhjetor 2011 (në Euro 000')	Më 31 Dhjetor 31, 2010 (në Euro 000')
PASURITË			
Paraja në dorë dhe në banka	4	23,310	25,581
Balancat me BQK-në	5	26,615	9,554
Kreditë e dhëna klientëve	6	93,821	87,235
Patundshmëritë dhe pajisjet	7	1,513	1,414
Pasuria e paprekshme	8	137	53
Parapagimet për tatimin nga të hyrat e korporates	16	168	82
Parapagimet për ndërtimin e zyreve	9	5,434	-
Pasoritë tjera		895	1,081
Gjithsej pasuritë		151,893	125,000
DETYRIMET			
Depozitat e klientëve	10	139,473	113,005
Të hyrat e shtyra		675	556
Llogaritë e pagueshme	11	274	171
Gjithsej detyrimet		140,422	113,732
KAPITALI AKSIONAR			
Kapitali aksionar	12	11,778	11,778
Rezerva e përgjithshme e rrezikut	13	102	102
Fitimi (Humbja) i/e akumuluar		(409)	(612)
Gjithsej kapitali aksionar		11,471	11,268
Gjithsej detyrimet dhe kapitali aksionar		151,893	125,000

Të autorizuar për lëshim nga Menaxhmenti më 30 Prill, 2012.

Mr. Valon Lluka
Menaxher Gjeneral

Ms. Syzane Kaçaniku
Menaxher Financiar

Shënimet e dhëna në faqet 8 deri 34 përbëjnë një pjesë integrale të këtyre pasqyrave financiare.

Banka Ekonomike Sh.a.
Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse
Për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2011

	Nota	Për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2011 (në Euro 000')	Për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2010 (në Euro 000')
Të hyrat nga interesi:			
Nga kreditë e dhëna klientëve		11,439	9,032
Nga depozitat dhe balancat me bankat		197	44
Gjithsej të hyrat nga interesi		11,636	9,076
Shpenzimet e interesit në detyrimet nga kostoja e amortizimit		(4,859)	(3,626)
Neto të hyrat nga interesi		6,777	5,450
Të hyrat nga komisionet dhe tarifat	14	2,251	1,758
Shpenzimet nga komisionet dhe tarifat		(141)	(113)
Të hyrat neto nga komisionet dhe tarifat		2,110	1,645
Të hyrat tjera operuese	15	346	284
Fitimet (humbjet) neto nga valutat e huaja		-	79
Gjithsej të hyrat		9,233	7,458
Shpenzimet e tjera operuese	16	(6,063)	(5,014)
Provizionimi për humbjet nga kreditë	6	(2,927)	(3,056)
Gjithsej shpenzimet operuese		(8,990)	(8,070)
Fitimi para tatimit të të hyrave		243	(612)
Shpenzimet e tatimit të të hyrave	17	(40)	-
Fitimi neto për vitin		203	(612)
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse		-	-
Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse		203	(612)

Shënimet e dhëna në faqet 8 deri 34 përbëjnë një pjesë integrale të këtyre pasqyrave financiare

Banka Ekonomike Sh.a.
Pasqyra e ndryshimeve në kapitalin aksionar
Për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2011

	Kapitali Aksionar	Rezerva e përgjithshme e rrezikut	Fitimi i mbajtur	Gjithsej Kapitali aksionar
	----- (në Euro 000') -----			
Balanca më 1 Janar 2010	11,778	102	671	12,551
Dividenti i paguar	-	-	(671)	(671)
Neto humbja e vitit	-	-	(612)	(612)
Balanca më 31 Dhjetor 31, 2010	11,778	102	(612)	11,268
Neto fitimi i vitit	-	-	203	203
Balanca më 31 Dhjetor 31, 2011	11,778	102	(409)	11,471

Shënimet e dhëna në faqet 8 deri 34 përbëjnë një pjesë integrale të këtyre pasqyrave financiare.

Banka Ekonomike Sh.a.
Pasqyra e rrjedhës së parasë
Për vitin që përfundon më 31 Dhjetor, 2011

	Note	Për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2011 (në Euro 000 ⁹)	Për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2010 (në Euro 000 ⁹)
Rrjedhja e parasë nga aktivitetet operuese			
Fitimi/(Humbja) për vitin para tatimit		243	(612)
Rregullimet për njësitë jo-kesh:			
Zhvlerësimi		533	556
Amortizimi		50	29
Humbjet neto në kredi dhe avance		2,927	3,056
Humbjet nga heqjet prej përdorimit të pronës dhe paisjeve		4	21
Shpenzimet e interesit		5,000	3,739
Të hyrat nga interesi		(13,690)	(10,790)
		(4,933)	(4,001)
(Zvogëlimi)/Rritja në balancat e kufizuara me		(17,061)	4,454
Rritjet në kredi për klientë		(9,709)	(26,628)
(Rritje)/Zvogëlimi në pasuritë tjera		(5,248)	(125)
Rritja në depozita nga klientët		26,045	26,803
Rritjet/zvogëlimet në detyrimet tjera		103	(3)
Rritje në të hyrat e shtyera		119	153
		(10,685)	653
Tatimi në të hyra i paguar		(126)	(40)
Interesi i paguar		(4,577)	(3,095)
Interesi i arkëtuar		13,886	10,733
Neto kesh-i nga aktivitetet operuese		(1,501)	8,251
 Rrjedhja e parasë nga aktivitetet investive			
Blerjet e pasurisë dhe paisjeve		(636)	(752)
Blerjet e pasurive të paprekshme		(134)	(4)
Të hyrat nga shitja e pasurisë dhe paisjeve		-	-
Neto paraja nga aktivitetet investive		(770)	(756)
 Rrjedhja e parasë nga aktivitetet financuese			
Dividenti i paguar gjatë vitit		-	(671)
Neto paraja nga aktivitetet financuese		-	(671)
 Neto rritjet/(zvogëlim) në para dhe ekuivalentët e parasë			
Paraja dhe ekuivalentët e parasë me 1 Janar, 2011		25,581	18,757
Paraja dhe ekuivalentët e parasë më 31 Dhjetor, 2011	4	23,310	25,581

Shënimet e dhëna në faqet 8 deri 34 përbëjnë një pjesë integrale të këtyre pasqyrave financiar.

1. AKTIVITETET KRYESORE

Në përputhshmëri me Bankën Qendrore të Kosovës ("BQK"), Banka Ekonomike Sh.a. Prishtinë ("Banka") mori licencën për zhvillimin e aktivitetit bankar më 28 Maj 2001 dhe filloi operimin e saj më 5 Qershor 2001. Zyra qendrore e Bankës gjendet në Rr. Migjeni Nr.1, Prishtinë, Kosovë. Banka operon njëkohësisht si bankë tregtare dhe kursimi për të gjitha kategoritë e klientëve brenda Kosovës, përmes rrjetit të saj prej 7 degësh të shtrira në Prishtinë, Gjakovë, Pejë, Prizren, Ferizaj, Mitrovicë dhe Gjilan.

2. BAZA PËR PËRPILIM

Banka mirëmban librat kontabël dhe përgatit pasqyrat financiare në përputhshmëri me koston historike dhe rregullat kontabël të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës ("rregulloret e BQK-së") që janë të aplikueshme për bankat. Rregulloret e BQK-së janë të bazuara në vendimet legale relevante që definojnë aplikimin e obligueshëm të Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF") në Kosovë, por rregulloret e BQK-së gjithashtu kërkojnë në mënyrë specifike aplikimin e trajtimeve kontabël që nuk janë në përputhshmëri me kërkesat e SNRF. Si pasojë, këto pasqyra duhet të lexohen (interpretohen) si të përgatitura në përputhshmëri me standardet e kontabilitetit dhe rregulloret që mbizotërojnë në territorin e Kosovës që janë shpallur në politikat kryesore të kontabilitetit në Notën 3 më poshtë.

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhshmëri me rregulloret e BQK-së, kërkon që menaxhmenti të bëjë vlerësime dhe parashikime që ndikojnë shumat e raportuara të pasurive dhe detyrimeve, shpalsje të pasurive dhe detyrimeve kontingjente në datën e pasqyrave financiare, dhe shumën e tyre të raportuar të të hyrave dhe shpenzimeve gjatë periudhës raportuese. Edhe pse këto vlerësime janë të bazuara në njohuritë më të mira të menaxhmentit për ngjarjet e tanishme dhe veprimet, rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga ato të vlerësuara.

3. POLITIKAT KRYESORE KONTABËL

a) Valuta e prezantimit

Valuta e raportimit të Bankës është Euro, e cila është valutë legale në territorin e Kosovës që nga 1 Janari 2002.

b) Vlerësimi i të hyrave dhe shpenzimeve

Të hyrat dhe shpenzimet nga interesi paraqiten në pasqyrën e të ardhurave për të gjitha instrumentet që sjellin interes në bazë aktuale duke përdorur metodën efektive të të ardhurave bazuar në çmimin aktual të blerjes, përveç për kreditë ku mbledhja është e pasigurtë të hyrat nga interesi njihen në bazë të faturave.

c) Rezervat e detyrueshme të likuiditetit

Në përputhje me rregulloret e BQK-së banka duhet të arrijë mesataren minimale të kërkesave të likuiditetit. Kërkesat e likuiditetit janë të përlllogaritura në baza mujore si 10% e depozitave bazë, e përcaktuar si mesatare totale e detyrimeve ndaj depozitave në pjesën jo-bankare-publike në Euro dhe monedhave tjera gjatë ditëve të punës të periudhës së mirëmbajtjes. Pasuritë me të cilat Banka mund të plotësojë kërkesat për likuiditetin e saj janë Euro depozitat me BQK-në dhe 50% e ekuivalentëve të parasë të denominuara në valuta lehtë të konvertueshme. Depozitat me BQK-në nuk duhet të jenë më të ulëta se 5% e bazës së depozitave të aplikueshme. Përderisa asetet përkatëse likuide nuk janë në dispozicion për financim të operacioneve të përditshme bankare, ato nuk janë përfshirë të paraja dhe ekuivalentët e parasë për qëllime të rrjedhës së parasë.

3. POLITIKAT KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)

d) Të hyrat nga tarifat dhe komisionet

Të hyrat tjera nga tarifat dhe komisionet, përfshirë tarifat për mirëmbajtjen e llogarive, komisionet e shitjeve, tarifat e depozitave, janë njohur kur shërbimet përkatëse janë kryer.

Të hyrat nga tarifat dhe komisionet shtyhen dhe njihen në baza të normës efektive të interesit të kredisë.

e) Kreditë e klientëve

Kreditë e lëshuara nga Banka duke u siguruar paratë drejtpërdrejtë huamarrësve janë kategorizuar si kredi ndaj klientëve.

Kreditë e lëshuara dhe paradhëniet njihen në momentin kur paratë u lëshohen huamarrësve. Fillimisht, kreditë e lëshuara dhe paradhëniet janë të regjistruara sipas kostos, e cila është vlera e tregut e pagesës së dhënë, dhe më pas janë mbajtur sipas kostos së amortizuar të zvogëluar për provizionin për kreditë e këqija.

Provizioni për rrezik të kredisë për kreditë e këqija është bërë në qoftë se ka prova objektive se banka nuk do të jetë në gjendje të mbledhë shumat sipas kushteve kontraktuale. Shuma e provizionit përcaktohet në bazë të Rregullave të BQK-së e rregulluar për shumat e rikuperueshme nga garancitë dhe kolaterali.

Provizioni për kreditë e këqija mbulon edhe humbjet e përgjithshme, ku ka dëshmi objektive se humbjet e mundshme janë të pranishme në komponentët e portofolit të kredisë në datën e bilancit të gjendjes. Këto janë llogaritur në bazë të modeleve historike të humbjeve në secilën komponentë, rangimit të kredive të caktuara për huamarrësit dhe reflektojnë mjedisin aktual ekonomik në të cilin veprojnë huamarrësit.

Kur një kredi konsiderohet e paarkëtueshme, ajo shlyhet nga provizioni i caktuar për kreditë e këqija. Kredi të tilla shlyhen pasi të gjitha procedurat e domosdoshme janë ndërmarrë dhe shuma e humbjeve është përcaktuar. Mbulimet e mëvonshme të shumave të kredisë të cilat paraprakisht janë shlyer janë kredituar në pasqyrën e te ardhurave.

Nëse shuma e provizionit për kreditë e këqija më vonë zvogëlohet si pasojë e ndonjë ngjarje pas shlyerjes, atëherë zvogëlimi i provizionit kreditohet në provizionin për shlyerjen e kredive në pasqyrën e te ardhurave.

Në vazhdim kemi klasifikimin e kategorive dhe shkallet e provizioneve minimale siç është caktuar nga BQK-ja:

Kategoritë	Norma e provizionit
Nën-standarde	20%
Të dyshimta	50%
Humbje	100%

Përveç provizioneve specifike të kërkuara ndaj ekspozimeve të klasifikuara, banka bën provizionimin e përgjithshëm ndaj portfolios të mbetur, jo të klasifikuar ose pjesëve të portfolios. Provizionimi i përgjithshëm, llogaritet si një përqindje ndaj portfolios të mbetur jo të klasifikuar.

3. POLITIKAT KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)

f) Valutat e huaja

Transaksionet në valuta të huaja të ndryshme nga Euro regjistrohen sipas kursit të këmbimit në datën e transaksionit. Ndryshimet e këmbimit që rrjedhin nga rregullimi i transaksioneve të denominuara në valuta të huaja janë përfshirë në pasqyrën e të ardhurave duke përdorur kursin e këmbimit të asaj date.

Asetet monetare dhe detyrimet e denominuara në valuta të huaja janë shndërruar në Euro sipas vlerës mesatare të kursit të këmbimit në datën e bilancit të gjendjes. Zërat jo-monetar që janë denominuar në valuta të huaja që mbahen me vlerën e tyre të tregut, janë rishndërruar në valutën funksionale me normat e këmbimit të datës në të cilën është përcaktuar vlera e tregut. Zërat jo-monetar që janë matur sipas kostos historike në valutë të jashtme nuk janë rishndërruar në valutën funksionale. Fitimet dhe humbjet e valutave të jashtme që rrjedhin nga shndërrimi i aseteve dhe detyrimeve janë paraqitur në pasqyrën e të ardhurave si fitim nga shndërrimi i këmbimit i jashtëm i zvogëluar për humbjet.

g) Prona dhe pajisjet

Patundshmëritë dhe pajisjet janë vlerësuar në bazë të koston duke zbritur zhvlerësimin e akumuluar dhe provizionin për heqjet nga përdorimi, aty ku kërkohet. Kosto përfshinë shpenzimet që janë direkt të përfshira në blerjen e pasurive. Aty ku njësi të një pasurie ose paisjeje kanë vlerë të ndryshme të jetëgjatësisë, ato paraqiten ndaras si njësi të veçanta (komponentët më të mëdha) të pasurisë dhe pajisjeve.

Kosto e zëvendësimit të një pjese të pasurisë ose paisjeve njihet në vlerën mbajtëse të njësisë, nëse pritet që përfitime të ardhshme ekonomike të lidhura me njësinë të rrjedhin dhe kostoja e tyre të mund të matet në mënyrë të besueshme. Shpenzimet ditore për mirëmbajtjen e pasurisë dhe paisjeve njihen në fitim ose humbje ashtu siç ndodhin.

Zhvlerësimi njihet në pasqyrën e të ardhurave sipas metodës drejtëvizore bazuar në jetëgjatësinë e secilës pjese të pasurisë dhe paisjeve. Pasuritë me qira zhvlerësohen për një periudhë më të shkurtë bazuar në marrëveshjen për qira dhe jetëgjatësinë së tyre. Vlerësimi i jetëgjatësisë për periudhën e tashme dhe krahasues është si më poshtë:

Kategoritë e pasurive	Jetëgjatësia
Pajisjet kompjuterike	5 vite
Veturat	5 vite
Mobiljet dhe pajisjet	5 vite

h) Pasuritë e paprekshme

Softueri i blerë nga Banka është vlerësuar sipas koston duke zbritur zhvlerësimin e akumuluar dhe humbjet e dëmtimeve të akumuluar. Shpenzimet e më pasme të softuerit kapitalizohen vetëm atëherë kur i rrisin përfitimet ekonomike të ardhshme të pasurisë specifike me të cilat kanë të bëjnë. Të gjitha shpenzimet e tjera shpenzohen në bazë të ndodhjes.

Amortizimi njihet në pasqyrën e të ardhurave sipas metodës drejtëvizore duke u bazuar në vlerësimin e jetëgjatësisë së softuerit, nga data që është futur në përdorim. Jetëgjatësia e softuerit konsiderohet të jetë dhjetë vite.

3. POLITIKAT KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)

i) Humbja e vlerës së pasurive

Rënia në vlerë e aktiveve të Bankës vlerësohet në bazë të dispozitave Ndërkombëtare të Kontabilitetit Standardi nr. 36 "Rënia në vlerë e Aseteve". Ky standard kërkon që një humbje nga rënia në vlerë të njihet kurdoherë që vlera bartëse e një pasurie e tejkalon shumën e rikuperueshme. Shuma e rikuperueshme e një pasurie është më e lartë e çmimit neto të shitjes dhe vlerës së saj në përdorim. Vlera në përdorim e një pasurie është vlera e tashme e rrjedhës së parasë që pritet të rrjedhë në të ardhmen nga përdorimi i vazhdueshëm i një pasurie dhe nga hedhja, shitja e saj.

j) Lizingu

Qiratë klasifikohen si qira financiare sa herë që kushtet e qirasë transferojnë në thelb të gjitha rreziqet dhe shpërblimet e pronësisë të qiramarrësi. Të gjitha kontratat e tjera janë të klasifikuara si qera operative.

Pagesat e bëra nën qeratë operative njihen në fitim ose humbje sipas metodës lineare gjatë afatit të qirasë. Rritjet e pranuar janë njohur si pjesë përbërëse e shpenzimeve totale për qira, gjatë kohëzgjatjes të qirasë.

k) Tatimi

Tatimi është paraqitur në pasqyrat financiare në përputhje me rregulloret në fuqi mbi tatimet në Kosovë. Efektive nga 1 Janari 2009, norma e tatimit mbi të ardhurat e korporatave është vendosur në 10% në përputhje me rregulloret tatimore të Kosovës aktualisht në fuqi, ligji nr. 03/L-113 "Tatimi në të Ardhurat e Korporatave".

Tatimi mbi të ardhurat për vitin përfshin tatimin aktual dhe ndryshimet në tatimin e shtyrë, nëse ka ndonjë. Tatimi aktual është llogaritur në bazë të fitimit të pritshëm të tatueshëm për vitin duke përdorur normat tatimore në fuqi në datën e bilancit. Fitimi i tatueshëm ndryshon nga fitimi siç raportohet në pasqyra sepse përfshihet zëra të të ardhurave ose shpenzimeve që janë të tatueshme ose zbritshme në vitet etjera dhe kjo më tej përjashton zërat që nuk janë të tatueshme ose të zbritshme. Tatimet tjera përveç tatimit në të ardhura janë të regjistruara brenda shpenzimeve operative.

Tatimi i shtyrë në të hyra është llogaritur duke përdorur metodën e detyrimeve të balancit të gjendjes për të gjitha ndryshimet e përkohshme që rrjedhin ndërmjet bazës së tatimit të pasurive dhe detyrimeve dhe shumave të tyre të bartura për qëllime të raportimit financiar.

Tatimi i shtyrë në detyrime është njohur për të gjitha ndryshimet e përkohshme të tatueshme. Tatimi i shtyrë- pasuri është njohur për të gjitha diferencat e përkohshme të zbritshme, tatimin e pashfrytëzuar-pasuri të bartur dhe humbjet nga tatimi të pashfrytëzuara, në atë masë që është e mundshme që fitimi i tatueshëm do të jetë në dispozicion kundrejt të cilit diferencat e përkohshme të zbritshme, tatimi i pashfrytëzuar- pasuri i bartur, dhe humbjet nga tatimi të pashfrytëzuara mund të shfrytëzohen. Vlera bartëse e tatimit të shtyrë në të hyra - pasuri është rishikuar në çdo datë të bilancit të gjendjes dhe është reduktuar në atë masë që nuk është më e mundshme që fitimi i tatueshëm përkatës të jetë në dispozicion që të lejoj që totali apo një pjesë e tatimit të shtyrë në të hyra - pasuri të jetë i shfrytëzueshëm.

Tatimi i shtyrë në pasuri dhe detyrime është matur me norma tatimore që pritet të zbatohet për periudhën kur pasuria realizohet ose detyrimi është i vendosur në bazë të normave të taksave që kanë qenë në fuqi ose kanë hyrë në fuqi në datën e bilancit të gjendjes.

3. POLITIKAT KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)

l) Paraja dhe ekuivalentët e parasë

Paraja dhe ekuivalentët e saj janë njësi që mund të konvertohen në kesh me një lajmërim të shkurtër dhe të cilat i ekspozohen një rreziku të parëndësishëm të këmbimit valutor. Shumat të cilat janë të lidhura me fondet që janë të një natyre të kufizuar janë të përjashtuara nga paraja dhe ekuivalentët e parasë.

m) Zotimet jashtë bilancore

Gjatë rrjedhës së zakonshme të biznesit banka hyn në zotime të lidhura me kredi, që janë të regjistruara në konto jashtë bilancore ku fillimisht përfshihen garancionet, letrat kreditore dhe kreditë e zotuar dhe të pa tërhequra. Këto angazhime financiare regjistrohen në bilancin e gjendjes së bankës vetëm kur këto bëhen të pagueshme. Provizionet për angazhimet dhe rastet e detyrimet kontingjente të humbjeve bëhen sipas rregulloreve të BQK-së.

n) Përfitimet/dobitë e punëtorëve

(i) Plani i definuar i kontributeve pensionale

Banka bën vetëm kontribute të detyrueshme për sigurim social të cilat ofrojnë përfitime pensionale për punëtorët deri në pensionim. Banka ka paguar vullnetarisht për çdo të punësuar 10 EUR çdo muaj kontribut pensional tek Skema e Fondit Sllloven të Pensioneve. Autoritetet lokale janë përgjegjëse për caktimin e pragut minimal të shumës për pensionet në Kosovë bazuar në një plan të definuar të kontributeve pensionale. Kontributet e Bankës për pensione hyjnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve kur të ndodhin.

(ii) Përfitimet afatshkurtra

Obligimet afatshkurtra për përfitimet e punëtorëve janë llogaritur në baza të padiskontuara (pazbritura) dhe shpenzohen kur shërbimi përkatës të jetë ofruar.

Një provizion njihet për shumën që pritet të paguhet si bonus afatshkurtër në para ose si profit në planet pensionale përfituese, nëse Banka ka ndonjë detyrim ligjor ose të tërthortë për të paguar këtë shumë si rezultat i shërbimeve të ofruara në të kaluarën nga punëtorët dhe detyrimi mund të matet besueshëm.

o) Gjykimet kritike kontabël dhe burimet e pasigurisë së vlerësimeve

Për aplikimin e politikave kontabël të bankës të përshkruara më lartë, menaxhmenti kërkohet të përdorë gjykimin, vlerësimet dhe supozimet në lidhje me vlerën e aseteve dhe detyrimeve që nuk mund të caktohet nga burime tjera. Vlerësimet dhe supozimet bazohen në eksperiençën dhe faktorët tjerë të rëndësishëm. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto vlerësime.

Vlerësimet dhe supozimet themelore rishikohen vazhdimisht. Ndryshimet në vlerësimet kontabël njihen në periudhën gjatë të cilës ndryshimet janë bërë në rastet kur vlerësimi e ndikon vetëm atë periudhë, ose në periudhën kur bëhet vlerësimi dhe në periudhat pasuese në rastet kur ndryshimi e ndikon periudhën aktuale dhe periudhat pauese.

Provizionimi i kredive për klientët

Për të vendosur nëse kreditë për klientët provizionohen në baza individuale duhet të vlerësohet vlera aktuale e rrjedhës së parasë prej kredive të klientëve, duke përfshirë shumat e rikuperueshme nga garancionet dhe kolaterali. Menaxhmenti i bankës përdor gjykimin për të vlerësuar rrjedhën e parasë nga portfolio kreditore dhe prej kolateralit.

4. PARAJA E GATSHME NË DORË DHE PARAJA NË BANKA

	Më 31 Dhjetor 2011	Më 31 Dhjetor 2010
	(në Euro 000')	(në Euro 000')
Paraja e gatshme në dorë	5,940	3,644
Llogaritë rrjedhëse me Bankat tjera	1,859	3,423
Depozitat afatshkurtë	15,511	18,514
Gjithsej paraja e gatshme në dorë dhe në banka	23,310	25,581

Depozitat afatshkurte të mbajtura në bankat jo-vendore në vitin 2011 marrin interes vjetor diku nga 0.35% deri 3.0% p.a. (2010: 0.09% deri 0.41% pa).

5. BALANCAT ME AUTORITETIN E BANKËS QENDRORE TË KOSOVËS

Balanca me Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës ("BQK") prej Euro 26,615 mijë më 31 Dhjetor 2011 (2010: Euro 9,554 mijë) paraqet rezervën e mbajtur në BQK, duke përfshirë shumën minimale të obligueshme të rezervës të kërkuar nga rregulloret e BQK-së. BQK-ja paguan interes deri sa shuma nuk tejkalon minimumin e rezervës së likuditetit (siç cekët në shënimin 3 (c)). Gjatë vitit 2011 norma e interesit të paguar ishte 0.35% p.a (2010: 0.1% p.a).

6. KREDITË PËR KLIENTËT

	Më 31 Dhjetor 2011	Më 31 Dhjetor 2010
	(në Euro 000')	(në Euro 000')
Kreditë		
Kreditë afatshkurtra	10,275	11,678
Kreditë afatgjata	66,415	56,354
Mbitërheqjet	20,864	22,202
	97,554	90,234
Interesi i mbledhur	586	782
	98,140	91,016
Provizionet për kreditë e këqija	(4,319)	(3,781)
Kreditë për klientët	93,821	87,235

Kreditë afatgjata kanë afat të maturimit nga 1 deri në 5 vite. Gjatë vitit që ka përfunduar më 31 Dhjetor 2011 banka i ka ngarkuar me interes klientët e saj nga 7% p.a. deri në 22.5 % p.a. (2010: 7% deri ne 22% p.a.).

Banka Ekonomike Sh.a.
Shënimet për pasqyrat financiare
Për vitin që përfundon më 31 Dhjetor, 2011

6. KREDITË PER KLIENTËT (VAZHDIM)

Lëvizjet në provizionime të kredive të këqija janë si më poshtë:

	2011	2010
	(në Euro 000')	(në Euro 000')
Provizionimi për kreditë e këqija më 1 Janar,	3,781	1,832
Heqjet gjatë vitit për shkak të pamundësisë së arkëtimit	(2,389)	(1,107)
Shpenzimet e bëra gjatë periudhës	2,927	3,056
Provizionimi për kreditë e këqija më 31 Dhjetor	4,319	3,781

Një analizë e industrisë e tërë portfolios së kredive të dhëna bizneseve para provizionimeve dhe interesit aktual jepet më poshtë:

Sekroti industrial	Më 31 Dhjetor, 2011		Më 31 Dhjetor, 2010	
	(në Euro 000')	%	(në Euro 000')	%
Shitjet me shumicë	36,965	38	32,870	36
Prodhuese	3,056	3	2,421	3
Konsumuese	28,329	29	18,942	21
Shërbime	10,769	11	10,377	12
Hotele dhe restorante	1,358	1	1,433	2
Agrikulturë	820	1	549	1
Konstruksion	13,543	14	19,913	22
Të tjera	2,714	3	3,729	4
	97,554	100	90,234	100

Më 31 Dhjetor 2011, dhjetë huamarrësit më të mëdhenj të Bankës përfshijnë 16.64% (2010: 48.27%) nga tërë portfolio e kredive. Huamarrësit nga palët e ndërlidhura përbëjnë 102.65% të equitetit (2010: 106%). Pas datës së Bilancit të Gjendjes, me datën 22 Mars 2012, ekspozimi ndaj palëve të ndërlidhura ka rënë në 75.92%

Më poshtë është një analizë e balancave neto të kredive të dhëna klientëve më 31 Dhjetor 2011:

Kategoria e kreditë	Afati i maturimit	Norma e aplikuar e provizionit	Principali i mbetur dhe	Provizionimi per humbjet (Në Euro 000')	Neto gjendja
			interesi aktual		
Standarde	0 – 30 days	0% to 4%	90,626	141	90,485
Vrojtuese	31 – 60 days	0% to 10%	1,381	11	1,370
Nen-standarde	61 – 90 days	20% to 25%	954	191	763
Dyshimta	91 – 180 days	50%	2,436	1,220	1,216
Humbje	over 180 days	100%	2,743	2,743	-
Provision për garantuesit				13	(13)
Neto kreditë e dhëna klientëve			98,140	4,319	93,821

6. KREDITË PER KLIENTËT (VAZHDIM)

Analiza e njëjtë për 31 Dhjetor 2010 është si vijon:

Kategoria e kredisë	Afati i maturimit	Norma e aplikuar e provizionit	Principal i mbetur dhe interesi akruar	Provizioni për humbjet (Në Euro 000')	Neto gjendja
Standarde	0 – 30 days	0% to 4%	82,181	81	82,100
Vrojtuese	31 – 60 days	0% to 10%	1,686	18	1,668
Nën-standarde	61 – 90 days	20% to 25%	3,826	765	3,061
Dyshimta	91 – 180 days	50%	823	412	411
Humbje	over 180 days	100%	2,500	2,500	-
Provizioni për garantuesit				5	(5)
Neto kreditë e dhëna klientëve			91,016	3,781	87,235

Banka Ekonomike Sh.a.**Shënimet për pasqyrat financiare**

Për vitin që përfundon më 31 Dhjetor, 2011

7. PRONA DHE PAJISJET

	Ndërtesat	Investimet në objektet e marra me qira	Inventari dhe pajisjet	Kompjuterët dhe pajisjet përkatëse	Veturat	Veturat me lizing financiar	Gjithsej
----- (në Euro 000') -----							
Kosto:							
Me 1 Janar 2010	-	515	1,534	677	272	52	3,050
Shtesat gjatë vitit	-	96	449	48	159	-	752
Heqja nga përdorimi	-	-	(27)	(5)	(47)	-	(79)
Më 31 Dhjetor 2010	-	611	1,956	720	384	52	3,723
Shtesat gjatë vitit	-	50	325	189	72	-	636
Heqja nga përdorimi	-	-	(8)	(6)	-	-	(14)
Më 31 Dhjetor 2011	-	661	2,273	903	456	52	4,345
Zhvlerësimi i akumuluar:							
Me 1 Janar 2010	-	329	857	484	141	-	1,811
Shpenzimet për vitin	-	77	299	108	61	11	556
Heqja nga përdorimi	-	-	(23)	(4)	(31)	-	(58)
Më 31 Dhjetor 2010	-	406	1,133	588	171	11	2,309
Shpenzimet për vitin	-	87	300	72	64	10	533
Heqja nga përdorimi	-	-	(5)	(5)	-	-	(10)
Më 31 Dhjetor 2011	-	493	1,428	655	235	21	2,832
Vlera neto:							
Më 31 Dhjetor 2011	-	168	845	248	221	31	1,513
Më 31 Dhjetor 2010	-	205	823	132	213	41	1,414

8. PASURITË E PAPERKSHME

	Softveri kompjuterik (në Euro 000')
Kosto:	
Më 1 Janar 2010	281
Shtesat gjatë vitit	4
Më 31 Dhjetor 2010	285
Shtesat gjatë vitit	134
Më 31 Dhjetor 2011	419
Zhvlerësimi i akumuluar:	
Më 1 Janar 2010	203
Shpenzimet për vitin	29
Më 31 Dhjetor 2010	232
Shpenzimet për vitin	50
Më 31 Dhjetor 2011	282
Vlera neto:	
Më 31 Dhjetor 2011	137
Më 31 Dhjetor 2010	53

9. PARAPAGIMET PËR NDËRTESEN

Banka është pajtuar me “Neë Co Iliria” që të blejë pronën me çmim prej EUR 5,643,335. Ndërtesa është në fazën e ndërtimit. Banka ka parapaguar shumën prej EUR 4,000 mijë me datën 31 Mars 2011 dhe EUR 1,434 mijë me datën 6 Dhjetor 2011.

Menaxhmenti planifikon të përdorë këtë pronë për zyrën e saj qendrore dhe zyrat e degëve.

10. DETYRIMET NDAJ KLIENTËVE

	Më 31 Dhjetor 2011 (në Euro 000')	Më 31 Dhjetor 2010 (në Euro 000')
Llogaritë rrjedhëse në Euro	17,883	15,064
Llogaritë rrjedhëse në valuta të huaja	1,266	1,095
Llogaritë e kursimit	7,353	6,257
Llogaritë e bllokuara	344	373
Depozitat Flexi	1,888	-
	28,734	22,789
Depozitat e afatizuara:		
Në Euro	104,519	85,584
Në valuta të huaja	4,131	2,966
	108,650	88,550
Interesi aktual	2,089	1,666
Gjithsej	139,473	113,005

Llogaritë rrjedhëse nuk sjellin interes.

Banka Ekonomike Sh.a
Shënimet për pasqyrat financiare
Për vitin që përfundon më 31 Dhjetor, 2011

10. DETYRIMET NDAJ KLIENTËVE (VAZHDIM)

Për depozitat e afatizuara, normat efektive të interesit gjatë vitit 2011 ishin:

<i>1 muaj</i>	<i>3 muaj</i>	<i>6 muaj</i>	<i>1 vit</i>	<i>18 muaj</i>	<i>2 vite</i>	<i>3 vite</i>	<i>5 vite</i>
%	%	%	%	%	%	%	%
2.4	3.0	3.8	4.7	5.1	5.2	5.4	6.0

Për depozitat e afatizuara, normat efektive të interesit gjatë vitit 2010 ishin:

<i>1 muaj</i>	<i>3 muaj</i>	<i>6 muaj</i>	<i>1 vit</i>	<i>18 muaj</i>	<i>2 vite</i>	<i>3 vite</i>	<i>5 vite</i>
%	%	%	%	%	%	%	%
2.4	3.0	4.0	4.9	5.1	5.2	5.4	6.0

Normat e interesave vjetore të aplikuara nga Banka gjatë vitit 2011 dhe 2010 për secilën periudhë të maturimit të depozitave janë si më poshtë:

Lloji i klientit	Deri në 30 ditë	31 deri 90 ditë	91 deri 180 ditë	181 deri 270 ditë	271 ditë dhe më shumë
2011:					
Kompanitë	2.40%	3.00%	3.80%	-	4.7-6.0%
Individët	2.40%	3.00%	3.80%	-	4.7-6.0%
2010:					
Kompanitë	2.40%	3.00%	4.00%	-	4.9-6.0%
Individët	2.40%	3.00%	4.00%	-	4.9-6.0%

11. LLOGARITË E PAGUESHME

	Më 31 Dhjetor 2011	Më 31 Dhjetor 2010
	(në Euro 000')	(në Euro 000')
Tatimet e tjera të pagueshme	87	59
Pensionet, asistencat sociale	25	18
Shpenzimet akruale	146	61
Lizingu financiar	16	33
Gjithsej	274	171

12. KAPITALI AKSIONAR

Kapitali aksionar i autorizuar dhe paguar përbëhet nga 46,010 aksione të rregullta me vlerë nominale 256 Euro më 31 Dhjetor 2011 dhe 2010, në shumën prej 11,778 mijë Euro.

Në përputhshmëri me Rregullin Nr. XXI për “Rritjen Minimale të Kapitalit të Bankës” autorizuar nën Seksionin 5 të Rregullës Nr.1999 / 21 lëshuar nga BQK-ja, minimumi i kapitalit të Bankës për të operuar në Kosovë duhet të jetë 5 milion Euro.

Një përmbledhje e aksionarëve të Bankës është si vijon:

Aksionari	Më 31 Dhjetor 2011		Më 31 Dhjetor 2010	
	Përqindja e pronësisë	(në Euro 000’)	Përqindja e pronësisë	(në Euro 000’)
Behgjet Pacolli	29.19	3,438	29.19	3,438
Hasan Hajdari	8.06	949	8.06	949
Raif Rexhepi	-	-	13.84	1,630
Xhabir Kajtazi	7.99	941	7.99	941
Zyhra Hajdari	4.78	563	4.78	563
Ismet Gjoshi	4.21	496	4.21	496
Afrim Pacolli	29.77	3,506	15.83	1,865
Selim Pacolli	13.80	1,625	13.80	1,625
Dukagjini-Operativa	0.54	64	0.54	64
Të tjerët me më pak se 1%	1.66	196	1.76	207
	100	11,778	100	11,778

Tabela më poshtë tregon lëvizjet në kapitalin aksionar gjatë vitit.

	2011 (në Euro 000’)	2010 (në Euro 000’)
Gjendja me 1 Janar,	11,778	11,778
Profiti i kapitalizuar gjatë vitit,	-	-
Gjendja më 31 Dhjetor,	11,778	11,778

Aksionet janë të zakonshme në natyrë dhe nuk kanë të drejta, preferenca ose kufizime të bashkangjitura me to.

13. REZERVA E PËRGJITHSHME E RREZIKUT

Bazuar në vendimin e Bordit të Drejtorëve të Bankës i cili është aprovuar nga aksionarët në asamblenë e përgjithshme të Bankës të mbajtur me 28 Prill 2004, balanca e fitimeve të mbajtur si më 31 Dhjetor 2003 në shumën prej 508 mijë Euro është përvetësuar në total me 8 Qershor 2004. Shuma prej 406 mijë Euro u është shpërndarë aksionarëve në formë të aksioneve të reja, dhe pjesa e mbetur në shumën 102 mijë Euro është transferuar në llogarinë e Rezervave të Rrezikut të Përgjithshëm, për të mbuluar rrezikun e përgjithshëm me të cilin është ballafaquar Banka gjatë rrjedhës normale të biznesit.

14. TË HYRAT NGA TARIFAT DHE KOMISIONET

	Për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2011	Për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2010
	(në Euro 000')	(në Euro 000')
Shërbimet bankare	1,334	1,037
Aktivitetet e huadhënies	742	575
Garancionet	175	146
Gjithsej	2,251	1,758

15. TË HYRAT TJERA OPERATIVE

	Për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2011	Për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2010
	(në Euro 000')	(në Euro 000')
Rigjenerimi nga shlyerja e kredive	330	251
Të hyra tjera	16	33
Gjithsej	346	284

16. SHPENZIMET TJERA OPERATIVE

	Për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2011	Për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2010
	(në Euro 000')	(në Euro 000')
Stafi	2,675	2,223
Qiraja	749	683
Zhvlerësimi	534	555
Amortizimi	50	29
Shpenzimet komunale dhe karburantet	244	167
Komunikimi	120	90
Udhëtimi	19	26
Reklamimi dhe marketingu	370	378
Materialet për zyre	69	47
Riparimi dhe mirëmbajtja	79	90
Sigurimi	149	127
Shpenzime profesionale	25	47
Printimi	28	30
Shërbimi i IT-së	143	92
Të tjera	809	430
Gjithsej	6,063	5,014

17. TATIMI MBI TË HYRAT

Norma e tatimit mbi të hyrat në Kosovë është 10% e të hyrave të tatueshme. Tabela më poshtë tregon llogaritjen e shpenzimeve rrjedhëse të tatimit mbi te hyrat.

	Për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2011 (në Euro 000’)	Për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2010 (në Euro 000’)
Fitimi para tatimit	243	(612)
Prima facie i kalkuluar me 10%	24	(61)
Ndikimi në tatim i shpenzimeve të palejueshme për qëllime tatimi	31	21
Ndikimi në tatim i shpenzimeve të lejueshme për qëllime tatimi	(15)	(11)
Tatimi në fitim	40	-
Humbjet e bartura të tatimit	-	(51)

Bashkrendimi i tatimit të pagueshëm /(arkëtueshëm) mbi të hyrat e korporatës si në datën e bilancit të gjendje:

	2011 (në Euro 000’)	2010 (në Euro 000’)
Tatimi mbi te hyrat (i parapaguar)/pagueshem më 1 Janar	(82)	(42)
Shpenzimet rrjedhëse të tatimit mbi të hyrat	40	-
Shpenzimet e tatimit mbi të hyrat të paguara gjatë periudhës	(126)	(40)
Tatimi mbi të hyrat (i parapaguar) më 31 Dhjetor 2011	(168)	(82)

18. ZOTIMET DHE KONTIGJENCAT

Zotimet dhe kontigjencat përfshijnë garancionet dhe letrat e kreditit të lëshuara për klientët. Balanca e tyre është e përbërë nga:

	2011 (në Euro 000’)	2010 (në Euro 000’)
Garancionet:		
Të siguruar nga depozitat	313	277
Të siguruar nga kolaterali tjetër	3,324	2,147
Gjithsej	3,637	2,424
Letër Kreditë	-	126
Gjithsej	3,637	2,550

Banka lejon garancione për klientët e saj. Këto instrumente bartin me vete rrezik të ngjashëm me ato të kredive të lejuara. Duke u bazuar në vlerësimet e menaxhmentit, nuk do të ketë humbje materiale nga garancionet e mbetura (pezull) si më 31 Dhjetor 2011.

Banka Ekonomike Sh.a
Shënimet për pasqyrat financiare
Për vitin që përfundon më 31 Dhjetor, 2011

18. ZOTIMET DHE KONTIGJENCAT (VAZHDIM)

Zotimet per lizingun operativ

Banka ka zotime pezull nga kontratat mbi qiranë me afate të përfundimit si më poshtë

	31 Dhjetor 2011	31 Dhjetor 2010
	(në Euro 000')	(në Euro 000')
Brenda një viti	671	597
Brenda dy deri në pesë vite	933	1,307
Gjithsej	1,604	1,904

Çështjet gjyqësore

Banka është e përfshirë në procedura gjyqësore rutinore që dalin nga rrjedha e zakonshme e biznesit. Më 31 Dhjetor 2011 Banka nuk ka pasur kërkesa gjyqësore që nuk ishin të vogla edhe sipas rrjedhës së zakonshme të biznesit. Bazuar në këshillat e brendshme dhe të jashtme, opinioni i menaxhmentit është që rezultatet përfundimtare nga këto çështje gjyqësore nuk do të kenë ndonjë humbje materiale për bankën dhe nuk është bërë provision për këto pasqyra financiare.

19. TRANSAKSIONET ME PALËT E LIDHURA

Një palë është e ndërlidhur me një entitet nëse, drejtpërdrejtë apo jo drejtpërdrejtë përmes një apo më shumë ndërmjetësuesve, pala kontrollon, është e kontrolluar nga apo është nën kontrollin e njëjtë me entitetin, pala kandonjë interes në entitetin i cili jep influencë domethënëse mbi entitetin, pala ka kontroll të përbashkët mbi entitetin, pala është ortak apo pala është anëtare e menaxhmentit udhëheqës në entitet apo në entitetin amë.

Më poshtë janë balancat me palët e lidhura në fund të vitit:

Lloji i palëve të lidhura	Bordi i Drejtorëve		Aksionarët kryesor dhe palët e lidhura me të	
	2011	2010	2011	2010
	----- (në Euro 000') -----			
Kreditë e klientëve:				
Kreditë pezull më 1 Janar,	1,686	823	21,913	15,796
Kreditë e lejuara gjatë vitit	1,274	1,782	13,157	17,414
Kreditë e ri paguara gjatë vitit	(1,640)	(919)	(24,615)	(11,297)
Kreditë pezull më 31 Dhjetor	1,320	1,686	10,455	21,913
Depozitat e klientëve:				
Depozitat e klientëve me 1 Janar,	472	146	35,180	32,248
Shumat e depozituara gjatë vitit	5,462	3,493	70,485	53,732
Shumat e tërhequra gjatë vitit	(5,252)	(3,167)	(62,868)	(50,800)
Depozitat e klientëve më 31 Dhjetor	682	472	42,797	35,180

19. TRANSAKSIONET ME PALËT E LIDHURA (VAZHDIM)

Më poshtë janë transaksionet me palët e lidhura gjatë vitit 2011.

	Bordi i drejtorëve		Aksionarët kryesor dhe palët e lidhura me të	
	Fund Viti 31 Dhjetor, 2011	Fund Viti 31 Dhjetor, 2010	Fund Viti 31 Dhjetor, 2011	Fund Viti 31 Dhjetor, 2010
	------(në Euro 000')-----		------(në Euro 000')-----	
Transaksionet:				
Të hyrat nga interesi	36	23	2,011	1,448
Të hyrat nga tarifat dhe komisioni	18	13	33	73
Shpenzimet e interesit	93	1	659	56

Transaksionet me drejtuesit (menaxhmentin e bankës)

Gjithsej shpërblimet e menaxhmentit udhëheqës të Bankës, të përfshira në “shpenzimet e personelit”:

	Fund Viti 31 Dhjetor, 2011 (në Euro 000')	Fund Viti 31 Dhjetor, 2010 (në Euro 000')
Përfitimet afatshkurta për punonjësit për BeD	51	58
Përfitimet afatshkurta për top-menaxhmentin	119	129
	<u>170</u>	<u>187</u>

20. VLERA E TREGUT DHE MENAXHIMI I RREZIKUT

a. Menaxhimi i rrezikut kapital

Banka menaxhon kapitalin e saj për t'u siguruar për vazhdimsinë e biznesit të saj (parimi i vazhdimësisë) derisa maksimizon kthimin për aksionarët përmes optimalizimit të balancës së detyrimeve dhe kapitalit. Strategjia e përgjithshme e bankës mbetet e pandryshuar që nga viti 2009.

Struktura e kapitalit të bankës përmban kapitalin e emetuar, rezervën e rrezikut të përgjithshëm dhe fitimin e mbajtur.

Raporti i borxhit ndaj kapitalit të aksionarëve

Këshilli për menaxhimin e rrezikut i bankës rishikon strukturën e kapitalit vazhdimisht. Si pjesë e këtij rishikimi, këshilli merr në konsideratë koston e kapitalit dhe rrezikun e lidhur për secilën klasë të kapitalit. Më 31 Dhjetor 2011 Banka nuk ka pasur instrumente borxhi.

b. Politikat kryesore kontabël

Detajet e politikave kryesore të kontabilitetit dhe metodave të adoptuara, duke përfshirë kriteret e njohjes, bazat e matjes dhe bazat mbi të cilat të hyrat dhe shpenzimet njihen, për secilën klasë të asetëve financiare, detyrimeve financiare dhe instrumenteve të kapitalit janë shpalosur në pikën 3 të pasqyrave financiare.

c. Kategoritë e instrumenteve financiare

Në fund të vitit Banka ka këto instrumente financiare:

	31 Dhjetor 2011 (në Euro 000')	31 Dhjetor 2011 (në Euro 000')
<u>Pasuritë Financiare:</u>		
Paraja në dorë dhe në banka	23,310	25,581
Balancat me BQK	26,615	9,554
Kreditë për klientët	93,821	87,235
<u>Detyrimet Financiare</u>	139,747	113,176

d. Objektivat e menaxhimit të rrezikut financiar

Funksioni i trezorit të korporatave ofron shërbime për bizneset, ko-ordinon qasjen në tregjet financiare të brendshme dhe të jashtme, monitoron dhe menaxhon rreziqet financiare në lidhje me operacionet e bankës, përmes raporteve të brendshme të rrezikut të cilat e analizojnë ekspozimin ndaj rrezikut në bazë të shkallëve dhe gjerësisë së rrezikut. Këto rreziqe përfshijnë rrezikun e tregut (duke përfshirë rrezikun e valutave, rrezikun e normave të interesit), rrezikun e kreditit dhe rrezikun e likuiditetit.

Zbatueshmëria në praktikë e politikave dhe e limiteve të ekspozimit, rishikohet vazhdimisht nga komitetet e menaxhimit dhe nga auditorët e brendshëm. Banka nuk merret ose tregton instrumente derivative financiare.

e. Rreziku i tregut

Aktiviteti i bankës e ekspozon atë fillimisht me rrezikun financiar në këmbimet valutore dhe normat e interesit. Rreziku i tregut nuk është i koncentruar në mënyrë domethënëse në rreyikun e valutave apo rrezikun e normave të interesit, sepse numri më i madh i transaksioneve të bankës janë në valutën lokale dhe normat e interesit janë fikse.

20. VLERA E TREGUT DHE MENAXHIMI I RREZIKUT (VAZHDIM)

f. Rreziku i valutave të huaja

Banka bënë transaksione në Euro dhe valuta tjera. Banka nuk ka hyrë në ndonjë këmbim derivati të parashikuar apo transaksione rrjedhëse deri më 31 Dhjetor 2011.

Banka i ekspozohet rrezikut valutor përmes transaksioneve në valuta të huaja. Meqë valuta në të cilën Banka i paraqet pasqyrat financiare është Euro, pasqyrat financiare të Bankës ndikohen nga lëvizjet në kursin e këmbimit valutor ndërmjet Euro-s dhe valutave tjera.

Ekspozimet e transaksioneve bankare rrisin fitimet ose humbjet ndaj valutave të huaja që njihen në pasqyrën e të ardhurave. Këto ekspozime përfshijnë pasuritë monetare dhe detyrimet monetare të bankës të cilat nuk janë denominuar në valutën matëse të bankës.

Analiza e ndjeshmërisë së valutave të huaja

Në fund vitin më 31 Dhjetor 2011, hapsira neto me valutat e huaja (e detajuar në tabelen poshtë) nuk është vlerë e rëndësishme për pasqyrat financiare në përgjithësi, ku menaxhmenti beson se cdo ndryshim në ratën valutore në të ardhmën nuk do të ketë ndikim të rëndësishëm në fitim apo humbje në të ardhmën.

Analiza e aseteve dhe detyrimeve monetare më 31 Dhjetor 2011 dhe 2010 sipas valutave në të cilat kanë qenë të denominuara është si vijon:

	Në fund vitin më 31 Dhjetor, 2011				
	EUR	USD	CHF	GBP	Total
	----- (në Euro 000') -----				
Pasuria					
Paraja dhe ekuivalentët e saj	17,436	3,988	1,840	46	23,310
Balanca me BQK-në	26,615	-	-	-	26,615
Kreditë e dhëna klientëve	93,821	-	-	-	93,821
Pasuritë tjera	6,329	-	-	-	6,329
	144,201	3,988	1,840	46	150,075
Detyrimet					
Depozitat e klientëve	129,559	7,791	2,097	26	139,473
Detyrimet tjera	274	-	-	-	274
	129,833	7,791	2,097	26	139,747
Neto valutat e huaja	14,368	(3,803)	(257)	20	10,328

20. VLERA E TREGUT DHE MENAXHIMI I RREZIKUT (VAZHDIM)

f. Rreziku i valutave të huaja (vazhdim)

	Më 31 Dhjetor, 2010				
	EUR	USD	CHF	GBP	Total
	----- (në Euro 000') -----				
Pasuria					
Paraja dhe ekuivalentët e saj	21,278	3,130	1,142	31	25,581
Balanca me BQK-në	9,554	-	-	-	9,554
Kreditë e dhëna klientëve	87,235	-	-	-	87,235
Pasuritë tjera	1,081	-	-	-	1,081
	119,148	3,130	1,142	31	123,451
Detyrimet					
Depozitat e klientëve	108,889	3,080	1,029	7	113,005
Detyrimet tjera	171	-	-	-	171
	109,060	3,080	1,029	7	113,176
Neto valutat e huaja	10,088	50	113	24	10,275

g. Rreziku nga normat e interesit

Rreziku nga normat e interesit përbëhet nga rreziku që vlera e instrumenteve financiare do të lëvizë si rezultat i lëvizjeve të normave të interesit në treg dhe rrezikun që afati i maturimit të pasurive që sjellin interes do të ndryshojë nga afati i maturimit të detyrimeve që përdoren për të financuar këto pasuri. Koha gjatë të cilës norma e interesit për një instrument financiar është e fiksuar kushtëzon se në çfarë mase banka do të jetë e ekspozuar ndaj rrezikut të normave të kamatës. Pasuritë dhe depozitat e klientëve të bankës mbartin norma fikse të interesit. Normat e interesit të aplikueshme në pasuritë dhe detyrimet financiare janë të shpalosura në shënimet relevante në këto pasqyra financiare.

Operacionet e Bankës janë subjekt i rrezikut të fluktuimit të normave të interesit në atë masë që interesi nga pasuritë dhe detyrimet maturon apo ricakton një çmim në kohë të ndryshme apo në shuma të ndryshme. Banka tenton që të zbus këtë rrezik duke monitoruar datat e ricaktimit të çmimit të pasurive apo detyrimeve. Veç kësaj, efekti aktual do të varet nga një varg faktorësh të tjerë, duke përfshirë nivelin ku ripagimet janë bërë më herët apo më vonë nga data e kontraktuar dhe ndërrimet në ndjeshmërinë e normës së interesit gjatë ricaktimit të çmimit dhe ndërmjetë valutave.

20. VLERA E TREGUT DHE MENAXHIMI I RREZIKUT (VAZHDIM)

g. Rreziku nga normat e interesit (vazhdim)

Analizat mbi normat e interesit janë detajuar më poshtë.

(a) Informata për mesatarën e të hyrave

Të hyrat mesatare të kategorive më të mëdha të mjeteve dhe detyrimeve të Bankës më 31 Dhjetor 2011 dhe 2010 janë si vijon:

Norma mesatare e interes	Euro		USD		CHF	
	2011 %	2010 %	2011 %	2010 %	2011 %	2010 %
Pasuritë :						
Paraja dhe ekuivalentet e saj	0.61	0.23	0.12	0.12	-	-
Balancat e kufizuara me BQK-në	0.34	0.10	-	-	-	-
Kreditë dhe avancet për klientët	11.87	11.65	-	-	-	-
Detyrimet:						
Depozitat nga klientët	4.07	3.94	2.2	1.83	0.31	0.21

Banka Ekonomike Sh.a
Shënimet për pasqyrat financiare
Për vitin që përfundon më 31 Dhjetor, 2011

20. VLERA E TREGUT DHE MENAXHIMI I RREZIKUT (VAZHDIM)

g. Rreziku nga normat e interesit (vazhdim)

(b) Analiza e ricaktimit të normave të interesit

Tabela e mëposhtme paraqet datat e ricaktimit të normave të interesit për pasuritë dhe detyrimet monetare të Bankës. Norma fikse të pasurive dhe detyrimeve janë raportuar duke u bazuar në planin e datave të ripagimit të principalit.

Më 31 Dhjetor 2011	Deri në 1 Muaj	1 deri në 3 Muaj	3 deri në 6 Muaj	6 deri në 12 Muaj	Më shumë se 1 vit	Gjithsej
------(në Euro 000')-----						
Pasuritë:						
Paraaja dhe ekuivalentët e saj	22,944	-	-	-	366	23,310
Që marrin interes	15,145	-	-	-	366	15,511
Që nuk marrin interes	7,799	-	-	-	-	7,799
Balancat me BQK	-	-	-	-	26,615	26,615
Që marrin interes	-	-	-	-	26,615	26,615
Kreditë për klientët	4,563	4,663	5,765	14,621	64,209	93,821
Që marrin interes	4,563	4,663	5,765	14,621	64,209	93,821
Parapagimet e tatimit në të hyra	-	-	168	-	-	168
Që nuk marrin interes	-	-	168	-	-	168
Pasuritë e tjera	37	-	-	5,878	414	6,329
Që marrin interes	-	-	-	-	237	237
Që nuk marrin interes	37	-	-	5,878	177	6,092
Gjithsej	27,544	4,663	5,933	20,499	91,604	150,243
Detyrimet:						
Depozitat nga klientët	40,215	8,449	22,186	39,735	28,888	139,473
Që marrin interes	21,571	8,449	22,186	39,735	28,888	120,829
Që nuk marrin interes	18,644	-	-	-	-	18,644
Detyrimet tjera dhe tatimi i pagueshëm	274	-	-	-	-	274
Që nuk marrin interes	274	-	-	-	-	274
Gjithsej	40,489	8,449	22,186	39,735	28,888	139,747
Hapsira	(12,945)	(3,786)	(16,253)	(19,236)	62,716	10,496
Hapsira kumulative	(12,945)	(16,731)	(32,984)	(52,220)	10,496	

Banka Ekonomike Sh.a
Shënimet për pasqyrat financiare
Për vitin që përfundon më 31 Dhjetor, 2011

20. VLERA E TREGUT DHE MENAXHIMI I RREZIKUT (VAZHDIM)

g. Rreziku nga normat e interesit (vazhdim)

(c) Analiza e ricaktimit të normave të interes (vazhdim)

Më 31 Dhjetor 2011	Deri në 1 Muaj	1 deri në 3 Muaj	3 deri në 6 Muaj	6 deri në 12 Muaj	Më shumë se 1 vit	Gjithsej
	------(në Euro 000')-----					
Pasuritë:						
Paraja dhe ekuivalentët e saj	25,219	-	-	-	362	25,581
Që marrin interes	18,152	-	-	-	362	18,514
Që nuk marrin interes	7,067	-	-	-	-	7,067
Balancat me BQK	-	-	-	-	9,554	9,554
Që marrin interes	-	-	-	-	9,554	9,554
Kreditë për klientët	5,403	1,765	2,591	23,262	54,214	87,235
Që marrin interes	5,403	1,765	2,591	23,262	54,214	87,235
Parapagimet e tatimit në të hyra	-	-	82	-	-	82
Që nuk marrin interes	-	-	82	-	-	82
Pasuritë e tjera	33	-	-	597	451	1,081
Që marrin interes	-	-	-	-	451	451
Që nuk marrin interes	33	-	-	597	-	630
Gjithsej	30,655	1,765	2,673	23,859	64,581	123,533
Detyrimet:						
Depozitat nga klientët	33,637	10,775	7,852	34,565	26,176	113,005
Që marrin interes	18,293	10,775	7,852	34,565	26,176	97,661
Që nuk marrin interes	15,344	-	-	-	-	15,344
Detyrimet tjera dhe tatimi i pagueshëm	171	-	-	-	-	171
Që nuk marrin interes	171	-	-	-	-	171
Gjithsej	33,808	10,775	7,852	34,565	26,176	113,176
Hapsira	(3,153)	(9,010)	(5,179)	(10,706)	38,405	10,357
Hapsira kumulative	(3,153)	(12,163)	(17,342)	(28,048)	10,357	-

20. VLERA E TREGUT DHE MENAXHIMI I RREZIKUT (VAZHDIM)

h. Rreziku kreditor

Banka i ekspozohet këtij rreziku përmes aktiviteteve të dhënies së kredive dhe në rastet kur ajo vepron si ndërmjetësuese në interes të klientëve ose të palëve të treta ose kur lëshon garancione. Në këtë aspekt, rreziku kreditor për bankën buron nga mundësia që palët e ndryshme mund të vonohen në kryerjen e obligimeve kontraktuale. Menaxhimi i rrezikut kreditor nga ekspozimi ndaj huamarrësve kryhet përmes analizave të rregullta të bonitetit të huadhënësve. Ekspozimi ndaj rrezikut kreditor pjesërisht menaxhohet edhe me anë të marrjes së kolateralit dhe garantuesve.

Ekspozimi parësor ndaj rrezikut kreditor del nga kreditë dhe avanset e dhëna për klientët e saj. Shuma e ekspozimit në këtë kontekst përfaqësohet nga vlera bartëse e mjeteve në bilancin e gjendjes. Veç kësaj, Banka është e ekspozuar edhe ndaj rrezikut kreditor jashtë-bilancor përmes dhënies së garancioneve.

Koncentrimi i rrezikut kreditor (si i atij bilancor dhe jashtë-bilancor) i cili lind nga instrumentet financiare, ekziston për palët tjera kur ato kanë karakteristika të ngjashme ekonomike që mund të bëjnë që aftësia e tyre për të paguar obligimet kontraktuale të ndikohet ngjashëm nga ndryshimet e kushteve ekonomike apo kushteve të tjera. Koncentrimet më të mëdha të rrezikut kreditor rrjedhin nga lloji i klientit në lidhje me kreditë dhe avanset e lëshuara nga banka apo nga garancionet e lëshuara.

Vlera bartëse e pasurive financiare e regjistruar në pasqyrat financiare, që është neto e humbjeve nga humbja e vlerës, përfaqëson maksimumin e ekspozimit të bankës ndaj rrezikut kreditor, pa marrë parasysh këtu vlerën e kolateralit të marrë. Ju lutem shikoni shënimin 6 për më shumë rreth ekspozimit të bankës në lidhje me sektorët e ndryshëm.

Në fund të vitit, kreditë janë të siguruara me forma të kolateralit si vijon:

	2011	%	2010	%
	(në Euro 000')		(në Euro 000')	
Hipotekat	14,915	15	15,960	18
Kolateral ne mjete monetare	10,136	10	14,074	15
Pengu	33,296	34	34,449	38
Mikse (Hipotekë dhe peng)	35,818	37	25,253	28
Garantues personal	3,389	4	498	1
Gjithsej	97,554	100	90,234	100

20. VLERA E TREGUT DHE MENAXHIMI I RREZIKUT (VAZHDIM)

i. Reziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit rrjedh nga financimi i përgjithshëm i aktivitetëve të bankës dhe nga menaxhimi i pozicioneve. Në të përfshihet rreziku i të qenit i paaftë për financimin e mjeteve me maturitet dhe normë të përshtatshme dhe rreziku i të qenit i paaftë që të likuideojë një mjet me çmim të arsyeshëm dhe në kohë të përshtatshme për të përmbushur detyrimet. Banka e monitoron likuiditetin e saj në baza ditore në mënyrë që të menaxhojë pagesën e obligimeve të saja ashtu siç maturojnë sipas afateve të tyre.

Fondet krijohen duke përdorur një numër të madh të instrumenteve përfshirë depozitat, huatë dhe kapitalin aksionar. Kjo e zgjeron fleksibilitetin e financimit, e kufizon varësinë në ndonjë burim të vetëm të fondeve dhe përgjithësisht e ul koston e fondeve. Banka bën përpjekje të mëdha që të ruaj një baraspeshim në mes vazhdueshmërisë së financimit dhe fleksibilitetit duke përdorur detyrime me maturitete të ndryshme. Banka vazhdimisht e vlerëson rrezikun e likuiditetit duke identifikuar dhe monitoruar ndryshimet në financim të cilat janë të nevojshme që ajo t'i përmbush synimet dhe qëllimet e përcaktuara në strategjinë e përgjithshme të Bankës. Veç kësaj, Banka zotëron një portfolio të mjeteve likuide si pjesë e strategjisë së menaxhimit për rrezikun e likuiditetit.

Tabela në vijim ofron një analizë të mjeteve dhe detyrimeve financiare të Bankës sipas grupeve të maturitetit të bazuar në periudhat e mbetura për kthim.

	Më 31 Dhjetor 2011					
	Deri në 1	1 deri 3	3 deri 6	6 deri 12	Më shumë	Gjithsej
	muaj	muaj	muaj	muaj	se 1 vit	
	------(në Euro 000')-----					
Pasuria						
Paraja në dorë dhe ekuivalentët e saj	22,944	-	-	-	366	23,310
Balancat me BQK-në	-	-	-	-	26,615	26,615
Kreditë dhe avancet e klientëve	4,563	4,663	5,765	14,621	64,209	93,821
Mjetet tjera	37	-	-	5,878	414	6,329
Gjithsej	27,544	4,663	5,765	20,499	91,604	150,075
Detyrimet						
Depozitat nga klientët	40,215	8,449	22,186	39,735	28,888	139,473
Detyrimet tjera dhe tat. i pagueshëm	274	-	-	-	-	274
Gjithsej	40,489	8,449	22,186	39,735	28,888	139,747
Hapsira e lik. 31 Dhjetor 2011	(12,945)	(3,786)	(16,421)	(19,236)	62,716	10,328
Hapsira kumulative 31 Dhjetor 2011	(12,945)	(16,731)	(33,152)	(52,388)	10,328	

20. VLERA E TREGUT DHE MENAXHIMI I RREZIKUT (VAZHDIM)

i. Reziku i likuiditetit

	Më 31 Dhjetor 2010					Gjithsej
	Deri në 1 muaj	1 deri 3 muaj	3 deri 6 muaj	6 deri 12 muaj	Më shumë se 1 vit	
	------(në Euro 000')-----					
Pasuria						
Paraja në dorë dhe ekuivalentët e saj	25,219	-	-	-	362	25,581
Balancat me BQK-në	-	-	-	-	9,554	9,554
Kreditë dhe avancet e klientëve	5,403	1,765	2,591	23,262	54,214	87,235
Mjetet tjera	33	-	82	653	313	1,081
Gjithsej	30,655	1,765	2,673	23,915	64,443	123,451
Detyrimet						
Depozitat nga klientët	33,637	10,775	7,852	34,565	26,176	113,005
Detyrimet tjera dhe tat. i pagueshëm	171	-	-	-	-	171
Gjithsej	33,808	10,775	7,852	34,565	26,176	113,176
Hapesira e lik. 31 Dhjetor 2011	(3,153)	(9,010)	(5,179)	(10,650)	38,267	10,275
Hapesira kumulative 31 Dhjetor 2011	(3,153)	(12,163)	(17,342)	(27,992)	10,275	-

j. Vlera e tregut e instrumenteve financiare

IFRS-ja i definojnë të ashtuquajturat hierarki të vlerave të tregut të cilat reflektojnë mënyrat e ndryshme për të arritur të vlera e tregut:

(a) *Tregu aktiv: Çmimi i cituar (Nivel 1)*

Observimi i çmimeve të cituara për instrumente identike financiare në tregun aktiv.

(b) *Teknika e vlerësimit duke përdorur inpute të observueshme (Nivel 2)*

Observimi i çmimeve të cituara për instrumente të ngjajshme në tregjet aktive ose çmimeve të cituara për instrumente identike ose të ngjajshme në tregjet jo-aktive ose përdorimi i vlerësimit të modeleve ku të gjithë inputet janë të observueshme.

(c) *Teknika e vlerësimit me inpute të rëndësishme të pa-observueshme (Nivel 3)*

Përdorimi i vlerësimit të modeleve ku një apo më shumë inpute të rëndësishme janë të pa-observueshme.

Vetëm nëse mënyra më e mirë e përcaktimit nuk është e mundshme atëherë metoda tjetër më e mirë e përcaktimit mund të përdoret. Për shkak se çmimet e tregut të cituara nuk janë në dispozicion në tregun e Kosovës, Banka ka përdorur teknikën e Nivelit të 2-të duke përdorur çmimet e produkteve të ngjajshme në treg.

20. VLERA E TREGUT DHE MENAXHIMI I RREZIKUT (VAZHDIM)

j. Vlera e tregut e instrumenteve financiare (vazhdim)

Më poshtë është e paraqitur vlera e tregut të pasurive dhe detyrimeve në fund të vitit.

	31 Dhjetor 2011 (në Euro '000')		31 Dhjetor 2010 (në Euro '000')	
	Shuma e bartur	Shuma e tregut	Shuma e bartur	Shuma e tregut
Paraaja dhe bilanci Bankar	23,310	23,310	25,581	25,581
Balanca me BQK	26,615	26,615	9,554	9,554
Kreditë konsumatorëve	93,821	94,051	87,235	87,235
Pasuritë tjera	6,329	6,329	1,081	1,081
Depozitat e klientëve	139,473	139,473	113,005	113,005
Llogaritë e pagueshme	274	274	171	171


21. NDODHITË PASUESE


Pas datës në bilancin përfundimtar, në mbledhjen e jashtëzakonshme të aksionerëve me 12 Mars 2012, është vendosur që të rritet kapitali i Bankës në vlerë prej EUR 3,000,064. Pagesa është procesuar me 20 Mars 2012.

Banka Ekonomike Sh.a.
Pasqyra e pozitës financiare
Për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2011

	Note	Më 31 Dhjetor 2011 (në Euro 000')	Më 31 Dhjetor [*] 31, 2010 (në Euro 000')
PASURITË			
Paraja në dorë dhe në banka	4	23,310	25,581
Balancat me BQK-në	5	26,615	9,554
Kreditë e dhëna klientëve	6	93,821	87,235
Patundshmëritë dhe pajisjet	7	1,513	1,414
Pasuria e paprekshme	8	137	53
Parapagimet për tatimin nga të hyrat e korporates	16	168	82
Parapagimet për ndërtimin e zyreve	9	5,434	-
Pasuritë tjera		895	1,081
Gjithsej pasuritë		151,893	125,000
DETYRIMET			
Depozitat e klientëve	10	139,473	113,005
Të hyrat e shtyra		675	556
Llogaritë e pagueshme	11	274	171
Gjithsej detyrimet		140,422	113,732
KAPITALI AKSIONAR			
Kapitali aksionar	12	11,778	11,778
Rezerva e përgjithshme e rrezikut	13	102	102
Fitimi (Humbja) i/e akumuluar		(409)	(612)
Gjithsej kapitali aksionar		11,471	11,268
Gjithsej detyrimet dhe kapitali aksionar		151,893	125,000

Të autorizuara për lëshim nga Menaxhmenti më 30 Prill, 2012.


Mr. Valon Llluka
Menaxher Gjeneral


Ms. Syzane Kaçaniku
Menaxher Financiar

Shënimet e dhëna në faqet 8 deri 34 përbëjnë një pjesë integrale të këtyre pasqyrave financiare.